

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
"HIDRODRINI" SH.A. PEJË**

Në mbështetje të nenit 17 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publik, Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidrodrini" SH.A, rishpall:

**KONKURS PUBLIK**

**Për plotësimin e vendit të punës:**

**ZYRTAR/E KRYESOR/E FINANCIAR/E**

**Numri i referencës: 375**

**Emërtimi:** Zyrtar/e kryesor/e financiar/e  
**Vendi:** Pejë  
**Ndërmarrja:** Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidrodrini" Sh.A. Pejë  
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv  
**Paga:** Sipas Rregullores në fuqi  
**Kohëzgjatja:** Për kohë të caktuar 3 vite me mundësi vazhdimi / 6 muaj periudha provuese

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencialë të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare nga fusha e financave, kontabilitetit dhe/ose auditim. Diplomat jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Të ketë se paku 5 vite përvojë pune në fushë të ngushtë specializimi (financa, kontabilitet, auditim);
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton ndërmarrja;
- Përparësi kanë kandidatët me master në financa, kontabilitet dhe auditim;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim financiar;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Aftësi ndër-personale;
- Aftësi për udhëheqje në arritjen e objektivave të përgjithshme të ndërmarrjes;
- Preferohen kandidatët me përvojë pune në ndërmarrje apo korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet

të lartë;

- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

## **Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Menaxhon çështjet financiare të kompanisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Komitetit të Auditimit në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi;
- Drejton dhe përgatit të dhënat e kompanisë për bilancin në fund të vitit, planin e biznesit dhe raportet financiare për Bordin;
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive, si dhe kërkon nga ta përgjegjësi dhe llogaridhënie;
- Shqyrton dhe aplikon ligjet dhe procedurat e ATK-së që rregullojnë çështjet tatimore dhe kujdeset për zbatimin me përpikëri të tyre;
- Kordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha llogarive dhe raporteve që kanë të bëjnë me ATK-në, dhe proceset e kontrollit që kryejnë institucionet tatimore;
- Analizon klimën financiare dhe tendencat e biznesit për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen;
- Interpreton informacionin financiar për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje të bordit të kompanisë;
- Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë dhe transaksionet e tjera financiare;
- Sipas autorizimeve të Kryeshefit Ekzekutiv përfaqëson ndërmarrjen përpara palëve të interesit: MEF, ARRU, Banka, etj.;
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore dhe vjetor për ARRU dhe NJPMNP;
- Mbikëqyrë ndihmësit financiar dhe punonjësit e tjerë në lehtësimin e operacioneve ditore, duke përfshirë kontrollin e të dhënave financiare;
- Bashkërendon punët e departamentit Financiar me atë të Burimeve Njerëzore;
- Bashkëpunon me BNJ në hartimin e një programi trajnimi për punonjësit e rinj të Departamentit;
- Bashkërendon punët me BNJ në vlerësimin e performancës së punëtorëve në kuadër të Departamentit;
- Merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Përgatit të dhënat e kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Formon komisionet për regjistrimet e fund vitit;
- Çfarëdo detyre tjetër e caktuar nga KE-ja;
- Për punën e tij përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

## **Procedura për aplikim:**

- Aplikacioni i cili mund të shkarkohet nga uebfaqja e kompanisë ([www.kru-hidrodrini.com](http://www.kru-hidrodrini.com));
- Një CV e detajuar (preferohet në shabllonin Europass);
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës;
- Letër motivimi (maksimum 500 fjalë);
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale / diplomat dhe certifikatat (kopje të noterizuara);
- Kopjet e certifikimeve përkatëse;
- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetimi i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i



dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se gjashtë muaj nga data e lëshimit);

**Informata të përgjithshme:**

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit;
- Intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit;

Dokumentacioni i kompletuar dërgohet i skanuar (në cilësi të mirë) në postën el: [f.gashi@hidrodrini.com](mailto:f.gashi@hidrodrini.com) ose në kopje fizike në zarf të mbyllur në adresën: Rr.“ Lekë Dukagjini“ nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës) në KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Dokumentet origjinale mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Inkurajohen të aplikojnë femrat dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Konkursi publikohet në mjetet e informimit publik në shtypin ditor “Koha Ditore” si dhe në dhe *Web – faqen* “ Hidrodrini” Sh. A. [www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com) .

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, nga data **11.05.2023**, afati i fundit për aplikim është deri më **25.05.2023** në ora **16:00h**.

**Vërejtje:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tre (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe që përfshihen në listën e ngushtë.

Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mbi aftësinë mjekësore për të vepruar (Lëshuar nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale) para nënshkrimit të kontratës.